



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 1355 Prot.

Tiranë, më 06.11 2017

VENDIM Nr. 207, datë 31.10.2017

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.12, datë 31.10.2017, pasi shqyrtoi Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik sipërfaqësor, në kuadër të *projektit "Ndërtimi i HEC-ve Kalori 1 & Kalori 2" në përroin e Ungrejt, Gjazit, Lezhë*- subjekti "RAFAELO 2002" sh.a. realizuar nga individ i licencuar në arkeologji Z. Skënder Muçaj,

VENDOSI:

1. Të miratojë Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik sipërfaqësor, në kuadër të *projektit "Ndërtimi i HEC-ve Kalori 1 & Kalori 2" në përroin e Ungrejt, Gjazit, Lezhë*- subjekti "RAFAELO 2002" sh.a. realizuar nga individ i licencuar në arkeologji Z. Skënder Muçaj.
2. Subjekti "RAFAELO 2002" sh.a. duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje tre palëshe me shoqëri të licencuar në arkeologji, e cila duhet të ndjekë në mënyrë periodike ditore kryerjen e punimeve të gërmimit të HEC-ve "Kalori 1 & Kalori 2", në përroin e Ungrejt, Gjazit, Lezhë, si dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik, e cila do të mbikëqyrë këtë shoqëri.
3. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10.2015 dhe përcaktimeve përkatëse të akt-marrëveshjes tre palëshe.
4. Të ngrihet një grup pune me përfaqësues të Institutit të Arkeologjisë dhe Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik, për vlerësimin e potencialit arkeologjik të Tumave të Kalorit, të identifikuar në kuadër të Vëzhgimit Arkeologjik të kësaj zone.

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: sekretaria.kka@asha.gov.al

Website: asha.gov.al

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
6. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI
MINISTËR



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: sekretaria.kka@asha.gov.al

Website: asha.gov.al